



**DREJTORATI PËR SHËRBIME PUBLIKE**

Data:	30.12.2016
Referencë:	
Nga:	Heset Sahiti - Drejtor i DSHP-së
Për:	Kryetarin e Komunës z. Imri Ahmeti
Lënda:	<b>Raporti i muajit Dhjetor 2016</b>

Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave gjatë muajit Dhjetor 2016, DSHP-ja ka kryer punë dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve dhe nga ana e institucioneve.

Kërkesat janë të paraqitura në mënyrë tabelore:

<b>Pasqyra e lëndëve (kërkesave) për muajin Dhjetor</b>				
<b>Nr. i kërkesave të pranuar</b>	<b>Të zgjidhura</b>	<b>Të refuzuara</b>	<b>Në kompetencë</b>	<b>Në procedurë</b>
<b>12</b>	<b>8</b>			<b>4</b>

- Janë dhënë Përgjigje, Vendime, Pëlqime, Njoftime të ndryshme sipas kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve.
- Barazimi i të hyrave me kompaninë “Algemi” sh.p.k e cila mirëmban dhe menaxhon me tregjet, dhe barazimi me të hyrat nga hapësirat publike.
- Mbikëqyrja e rrugëve dhe e trotuareve në qytetin e Lipjanit si dhe rrugëve lokale.
- Mbikëqyrja e kompanisë KRM “Pastrimi” e cila bënë pastrimin e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Lipjanit – pastrimi dimëror
- Mbikëqyrja e kompanisë “Eing Com” e cila bënë mirëmbajtjen e parqeve dhe parkingjeve në qytetin e Lipjanit.
- Janë bërë kërkesa për zotim të mjeteve asfaltimi i rrugës ne Medvec bashkëfinancim me donator.
- Kërkesë Ministrisë se Infrastrukturës për analizim te projektit asfaltimi i rrugës Lipjan Magurë për mundësinë e zhvendosjes se urës ne fshatin Qylagë
- Marrja pjese ne trajnimin për performancë komunale
- Vizita në teren për zhblokim të rrjeteve të kanalizimit:
- Kërkesë Drejtorisë së Prokurimit për inicim të procedurave për tregun e mobiljeve
- Raporte Drejtorisë se Prokurimit për realizimin e punimeve sipas kontratave.
- Punë tjera në teren sipas kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe institucioneve.
  
- Mbikëqyrja në ndërtimin e kanalizimit në fshatin Rubovc, punimet vazhdojnë.
- Mbikëqyrja e punimeve mirëmbajtja e rrjeteve ekzistuese të kanalizimit
- Mbikëqyrja e punimeve në asfaltimin e rrugëve të qytetit të Lipjani, punimet janë duke vazhduar, kanë filluar me asfaltim të disa rrugëve, dhe po vazhdon me përgatitjen e rrugëve tjera
- Mbikëqyrja e punimeve në instalimin e ngrohjes qendrore nëpër disa shkolla të Komunës së Lipjanit, punimet janë duke vazhduar..
- Mbikëqyrja e pllakos me kubëza në oborrin e Xhamisë në Lipjan dhe rregullimi i infrastrukturës në varrezat e Lipjanit punimet janë në përfundim e sipër
- Mbikëqyrja e punimeve në ndërtimin e sheshit “Adem Jashari” punimet janë duke vazhduar

- Mbikëqyrja e punimeve në asfaltimin e rrugëve në Gadime të Ultë punimet janë duke vazhduar me shtrirjen dhe ngjeshjen e zhavorrit, dhe është bërë asfaltimi i një pjese te rrugës prej urës te shpella në drejtim të lagjes Lekiqi dhe asfaltimi i rrugës që shpie te varrezat
- Mbikëqyrja e punimeve në ndërtimin e fushave te sportit në fshatrat Konjuh dhe Medvec.
- Puna me palë dhe punë tjera në teren sipas kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe institucioneve.
- Janë kryer edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesës së DSHP-së me urdhër të Drejtorit.

<b>Pasqyra e aktiviteteve të DSHP-së</b>		
<b>Nr</b>	<b>Lloji i aktivitetit</b>	<b>Nr.</b>
<b>1</b>	<b>Kërkesa, Vendime, njoftime, pëlqime, përgjigje si dhe shkresa te ndryshme organeve brenda komunës dhe institucioneve tjera</b>	<b>10</b>
<b>2</b>	<b>Takime me përfaqësuesit e fshatrave</b>	<b>2</b>
<b>3</b>	<b>Përgatitja e paramasave dhe parallogarive</b>	<b>2</b>
<b>4</b>	<b>Takime zyrtare në Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit</b>	<b>0</b>
<b>5</b>	<b>Takime zyrtare në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor</b>	<b>0</b>
<b>6</b>	<b>Takime zyrtare në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal</b>	<b>0</b>
<b>7</b>	<b>Vizita në terren</b>	<b>43</b>
<b>8</b>	<b>Pjesëmarrja në konferenca dhe trajnime të ndryshme</b>	<b>4</b>
<b>9</b>	<b>Pjesëmarrja në hapjen dhe vlerësimin e tenderëve</b>	<b>0</b>